

Bashkia Himarë pjesë e programit european URBACT Pioneers Accelerator



Bashkia Himarë është përzgjedhur të jetë pjesë e Programi URBACT Pioneers Accelerator, I cili financohet nga Bashkimi Evropian përmes Programit Interreg URBACT IV, dhe synon forcimin e kapaciteteve të qyteteve për zhvillim të qëndrueshëm urban, në përputhje me kuadrin politik të BE-së dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Programi ndihmon qytetet të adresojnë sfida konkrete urbane përmes shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe praktikave më të mira evropiane.

Fokusi i Bashkisë Himarë në këtë program:

Bashkia Himarë do të angazhohet në zbatimin e një projekti pilot me fokus krijimin e një sistemi efikas të transportit urban në qytetin e Himarës, i gjelbër dhe i përballueshëm që përmirëson lëvizshmërinë, redukton trafikun, ndotjen dhe nxit qasjen në shërbime.

Financimi

Për pjesëmarrjen në këtë nismë, Bashkia Himarë përfiton një grant prej 35,000 €, të financuar në masën 95% nga BE përmes URBACT-it.

Ky financim mbulon:

- angazhimin e stafit në procesin mësimor 18-mujor (Prill 2025 – Shtator 2026);
- zhvillimin e një projekti pilot konkret në territorin e Bashkisë Himarë;
- trajnime, vizita studimore dhe shkëmbime për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Pjesëmarrja në URBACT Pioneers Accelerator vendos Bashkinë Himarë në një rrjet rajonal qytetesh që punojnë për zgjidhje inovative në fushat e:

- menaxhimit të mbetjeve,
- mobilitetit të qëndrueshëm,
- turizmit të qëndrueshëm,
- zhvillimit ekonomik lokal, dhe
- përfshirjes sociale.

Përmes kësaj nisme, Himara ndërton themelet për një qytet në përputhje me prioritetet e Bashkimit Evropian dhe nevojat e komunitetit lokal.

4. Projekti Pilot i Bashkisë Himarë

“Krijimi i një Sistemi Efikas të Transportit Urban në Qytetin e Himarës”

Ky projekt përfshin:

- hartimin e itinerareve optimale që lidhin zonat urbane dhe rurale;
- vendosjen e stacioneve të pajisura me tabela informuese për pasagjerët;
- sigurimin e mjeteve të transportit me efikasitet energjetik (preferohet elektrik);
- ndërgjegjësimin e komunitetit për përdorimin e transportit publik;
- integrimin me politikat e zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe turizmit.

Projekti lidhet drejtpërdrejt me objektivat e Bashkisë Himarë për:

- uljen e ndotjes së mjedisit,
- reduktimin e trafikut gjatë sezonit turistik,
- lehtësimin e aksesit të banorëve dhe vizitorëve në qytet.

Pjesëmarrja në URBACT Pioneers Accelerator është një mundësi e rëndësishme për Bashkinë Himarë për të ndërtuar themelet e një transporti urban të qëndrueshëm dhe për të qenë pjesë e një rrjeti rajonal qytetesh që punojnë për:

- mobilitet të gjelbër,
- turizëm të qëndrueshëm,
- zhvillim ekonomik lokal,
- menaxhim të mbetjeve dhe përfshirje sociale.

Ky proces ndihmon Bashkinë Himarë të përafrohet me prioritetet e Bashkimit Evropian, duke adresuar njëkohësisht nevojat reale të komunitetit lokal.